



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo administracija lokalne samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Prishtinë, 30.04.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), bazuar në Planin e punës ka si objektiv Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Joqeveritare për vitin 2026, shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË  
PROJEKTEVE/PROGRAMEVE TË OJQ-VE NË FUSHËN E QEVERISJES LOKAL**

**Qëllimi i thirrjes publike**

Kjo thirrje publike për projekt-propozimet e organizatave të shoqërisë civile ka për qëllim realizimin e projekteve/ programeve në fushën e qeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, lidhur me zbatimin e objektivave strategjike të përcaktuara me Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale, 2016 - 2026. Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, (MAPL) u bënë thirrje të gjitha organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës, , që të aplikojnë me projekt-propozime për mbështetje financiare me qëllim të realizimit të aktiviteteve të përcaktuara me këtë thirrje.

Qëllimi kryesor i MAPL-së është të mbështesë iniciativa që kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. MAPL, përmes kësaj thirrjeje, synon të përkrahë projekte të qëndrueshme dhe inovative që adresojnë nevojat reale të komunave dhe qytetarëve, duke promovuar praktika të mira të qeverisjes lokale dhe shërbimeve digjitale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal u bën thirrje të gjitha Organizatat Joqeveritare (OJQ) të regjistruara në Republikën e Kosovës, që të aplikojnë për mbështetje financiare në kuadër të kësaj thirrjeje, në përputhje me politikat programore të MAPL-së. OJQ-të, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt-propozime lidhur me aktivitetet e tyre sipas objektivave të përcaktuara në planin vjetor të mbështetjes financiare publike për organizatat joqeveritare 2026. OJQ-të mund të aplikojnë me një projekt-propozim që kontribuon në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme

**1. Objektivat e projekteve**

MAPL nëpërmes rezultateve të kësaj thirrje synon të arrij përmbushjen e objektivave të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale:

1. Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal;
2. Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale;
3. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;
4. Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive;
5. Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të afirmimit dhe zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komuna.

### Financimi

Vlera e planifikuar për këtë thirrje është 500,000.00 €. MAPL planifikon të financoj deri në 10 projekt/propozime. Shumat për financim për një projekte do të jetë nga 30,000.00 € deri në 80,000.00 €.

Objektivat	Shuma financimit e
1 Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal. 2 Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale. 3 Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët. 4 Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive 5 Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të afirmimit dhe zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komuna.	500,000.00 €

Nga kjo thirrje do të përzgjidhen OJQ, të cilat duhet t'i përmbushin të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë thirrje. MAPL, mban të drejtën për mosshpërndarjen e të gjitha mjeteve financiare të planifikuara në këtë thirrje, nëse komisioni vlerëson që projekt-propozimet nuk janë në përputhje me objektivat e kësaj thirrje.

### 2. Kalendari indikativ i realizimit të thirrjes

30.04.2026 - Hapja e thirrjes  
21.05.2026 - Afati i fundit për aplikimet  
11.05.2026 - Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen  
11.05.2026 - Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen  
28.05.2026 - Publikimi i rezultateve paraprake, njoftimi i aplikantëve  
02.06.2026 - Afati për dorëzimin e ankesave  
08.06.2026 - Vendimi i Komisionit të Ankesave  
30.06.2026 - Nënshkrimi i kontratës  
30.11.2026 - Dorëzimi i raportit përfundimtar pas përfundimit të projektit

### 3. Lista e dokumenteve të nevojshme

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Formulari i propozim buxhetit;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit (nëse është e aplikueshme);
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
7. Forma e deklaramentit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Formulari për deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit (për ekspertet e angazhuar);
9. Deklaratë vjetore për vitin 2023/2024/2025, (pasqyrat financiare nga ATK );
10. Dokument/e që dëshmojnë mbi qarkullimin e përgjithshëm financiarë të OJQ-së gjatë 3 viteve të fundit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike, të cilat duhet të jenë të barabarta me ose të tejkalojnë vlerën e përgjithshme 200,000.00 €
11. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore;
12. Dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale;
13. Dëshmi se ndaj OJQ-së nuk ka evidencë se është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit.
14. Organizatat që aplikojnë në këtë thirrje, duhet që në 5 vitet para datës së publikimit të kësaj thirrje publike të kenë së paku tre (3) referenca/dëshmi relevante për projekte të realizuara që janë relevante me qëllimin dhe objektivat e kësaj thirrje.
15. Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të OJQ-së.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web-Faqen e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

#### 4. Dorëzimi i aplikacioneve

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Arkivin e MAPL në zarf të mbyllur, (në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit) ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike USB. Dokumentet e kompletuara dorëzohen vetëm fizikisht jo më vonë se data 21.05.2026 ora 16:00 në adresën e mëposhtme:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, ish-Pallati i Rilindjes, Kati I (përdhese)  
Prishtinë, Kosovë, 10000  
Kontakt: tel: +383(038) 200 64 209  
E-mail: [info.mapl@rks-gov.net](mailto:info.mapl@rks-gov.net)

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

#### 5. Kontakt

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar pyetje në e-mail adresën: [info.mapl@rks-gov.net](mailto:info.mapl@rks-gov.net), jo më vonë se, 11.05.2026. Përgjigjet do të kthehen në formë elektronike.

#### 6. Udhëzimet për aplikantët

Së bashku me këtë thirrje publike janë publikuar edhe **Udhëzimet për Aplikantët** për informata më të hollësishme në lidhje me thirrjen publike.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo administracija lokalne samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

Prishtinë, 30.04.2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË  
PROJEKTEVE/PROGRAMEVE TË OJQ-VE NË FUSHËN E QEVERISJES LOKAL**

**UDHËZIMET PËR APLIKANTËT**

Data e hapjes së thirrjes: **30.04.2026**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: **21.05.2026, ora 16:00**

Përmbajtja:

**1. Thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e qeverisjes lokal**

- 1.1 Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike
- 1.2 Objektivat e projektit
- 1.3 Vlera e planifikuar për mbështetje financiare
- 1.4 Kriteret e përgjithshme
- 1.5 Kriteret specifike
- 1.6 OJQ-të të cilat nuk mund të aplikojnë
- 1.7 Partnerët në zbatimin e projektit

**2. Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme**

- 2.1 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
- 2.2 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme
- 3.3 Shpenzimet e papranueshme

**3. Si të aplikoni**

- 3.1 Forma e projekt propozimit
- 3.3 Forma e propozim buxhetit
- 3.4 Dorëzimi i aplikacioneve
- 3.4 Afati për dorëzimin e aplikacioneve
- 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje

**4. Vlerësimi i aplikacioneve/fazat**

- 4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme
- 4.2 Publikimi i vendimit paraprak
- 4.3 Dokumentacion shtesë

**5. Kalendar i indikativ i realizimit të thirrjes**

**6. Periudha dhe shtrirja gjeografike e zbatimit të projekteve**

**7. Ankesat**

**8. Lista e formave**

**1. Thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e qeverisjes lokal**

**1.1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike**

Kjo thirrje publike për projekt-propozimet e organizatave të shoqërisë civile ka për qëllim realizimin e projekteve/ programeve në fushën e qeverisjes lokale të Republikës së Kosovës, lidhur me zbatimin e objektivave strategjike të përcaktuara me Strategjinë

për Vetëqeverisje Lokale, 2016 – 2026. Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, (MAPL) u bënë thirrje të gjitha organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës, që të aplikojnë me projekt-propozime për mbështetje financiare me qëllim të realizimit të aktiviteteve të përcaktuara me këtë thirrje.

Qëllimi kryesor i MAPL-së është të mbështesë iniciativa që kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike. MAPL, përmes kësaj thirrjeje, synon të përkrahë projekte të qëndrueshme dhe inovative që adresojnë nevojat reale të komunave dhe qytetarëve, duke promovuar praktika të mira të qeverisjes lokale dhe shërbimeve digjitale.

## 1.2. Objektivat e projekteve

Organizatave të shoqërisë civile në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt-propozimet e tyre në fushën, si vijon:

- **Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikatat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal;**
- **Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale;**
- **Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;**
- **Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive;**
- **Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të afirmimit dhe zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komuna.**

Organizatave të shoqërisë civile mund të aplikojnë vetëm me një (1) projekt-propozim në kuadër të kësaj thirrjeje.

## 1.3 Vlerat e planifikuara e mbështetjes financiare

Vlera e planifikuar për këtë thirrje është 500,000.00 €. Kjo vlerë financohet nga buxheti i MAPL-së, kategoria e subvencioneve. Vlera e planifikuar për këtë thirrje është 500,000.00 €. MAPL planifikon të financoj deri në 10 projekt/propozime. Shumat për financim për një projekt do të jetë nga 30,000.00 € deri në 80,000.00 €. MAPL, mban të drejtën për mos-shpërndarjen e të gjitha mjeteve financiare të planifikuara në këtë thirrje, nëse komisioni vlerëson që projekt-propozimet nuk janë në përputhje me objektivat e kësaj thirrjeje.

### Objektivat

1. **Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikatat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal;**

### Shuma e financimit

500,000.00 €

2. Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale;
3. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të organeve të vetëqeverisjes lokale për të përmbushur kërkesat e qytetarëve dhe për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët;
4. Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive;
5. Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të afirmimit dhe zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor në komuna.

Nga kjo thirrje do të përzgjidhen dy ose më shumë OJQ, të cilat duhet ti përmbushin të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë thirrje, dhe të cilat dëshmojnë përvojë në zbatimin e projekteve në fushën e vetëqeverisjes lokale.

## 2. Kriteret e aplikimit

**2.1 Kriteret e përgjithshme.** Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale si në vijim:

1. Të jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asocimit në Republikën e Kosovës;
2. Të jetë e pajisur me numër fiskal dhe numër të regjistrimit;
3. Të ketë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme ndaj ATK-së;
4. Të dëshmojnë se gjatë 3 viteve të fundit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike kanë pasur qarkullim të përgjithshëm i cili është i barabartë me ose tejkalon vlerën e përgjithëshme 200,000.00 €;
5. Të mos jetë në proces falimentimi apo në proces të shuarjes;
6. Të mos ketë shkelur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike;
7. Të mos ketë pranuar mjete financiare për të njëjtin aktivitet gjatë këtij viti;
8. Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit të projektit/programit së bashku me formularin e propozim buxhetit.
9. Në rastin e aplikimit në partneritet, të gjitha kriteret e lartë cekura do të zbatohen në tërësi edhe për OJQ-në partnere me përjashtim të kriterit numër 3, 5 dhe 9.

## 2.2 Kriteret specifike

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar aplikuesi duhet të plotësojë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara në vijim:

- Të dorëzoj brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit të aktiviteteve, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Të dorëzohen të dhëna për stafin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimi nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare;
- Në rast të bashkëfinancimit duhet të sigurohen dëshmitë e duhura për projektet ku aplikohet bashkëfinancimi;
- Organizatat që aplikojnë në këtë thirrje, duhet që në 5 vitet para datës së publikimit të kësaj thirrje publike të kenë së paku tre (3) referenca/dëshmi relevante për projekte të realizuara që janë relevante me qëllimin dhe objektivat e kësaj thirrje

### **2.3 OJQ-të të cilat nuk mund të aplikojnë**

OJQ-të të cilat nuk përmbushin kriteret e përcaktuara më lartë nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare ose në rast aplikimi dosja e tyre nuk do të merret për bazë në fazën e shqyrtimit dhe nuk do të kualifikohen për mbështetje financiare.

### **2.4 Partnerët në zbatimin e projektit**

Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë për mbështetje financiare të projekteve të tyre në kuadër të partneritetit me OJQ të tjera. Në rast se propozohet implementimi i projekteve në partneritet të OJQ-ve duhet të dorëzohet deklarata e partneritetit dhe dëshmitë e nevojshme të përcaktuara më lartë tek kriteret e përgjithshme.

Duhet të merren për bazë kërkesat formale të përcaktuara në formularin 12 të Rregullores MF- Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Partneriteti përfshinë marrëdhëniet mes OJQ-ve që nënkupton përgjegjësi në zbatimin e programit/projektit të financuar nga ofruesit e mbështetjes financiare. Në mënyrë që projekti/programi të zbatohet pa problem të gjitha organizatat që janë pjesë e partneritetit duhet të pajtohen me parimet e praktikës së mirë në partneritet:

1. Para dorëzimit të aplikimit tek ofruesi i mbështetjes financiare të gjithë partnerët do të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacioneve dhe të kuptojnë rolin e tyre në projekt/program;
2. Të gjithë partnerët autorizojnë Aplikuesin për t'i përfaqësuar ata në të gjitha marrëdhëniet me MAPL-në në kontekstin e zbatimit të projektit/programit;
3. Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere do të takohen rregullisht dhe të punojnë së bashku për zbatimin e projektit/programit, vlerësimin dhe shqyrtimin e mënyrave për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive në zbatimin e projektit;

4. Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e pasqyrave të përbashkëta përshkruese dhe të veçanta financiare dhe aplikuesi në emër të të gjithë partnerëve paraqet ato tek MAPL;
5. Propozimi për ndryshime në partnerët e projektit duhet të bëhet me marrëveshje në mes të partnerëve ndërsa aplikuesi e dorëzon atë tek ofruesi i mbështetjes financiare.

### 3. Shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

#### 3.1 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

#### 3.2 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Organizimi i aktiviteteve edukuese, tryeza të rumbullakëta (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji i aktivitetit, çmimi i secilit shërbim dhe grupi i synuar).
2. Material shpenzues për zbatimin e projektit;
3. Shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj);
4. Shërbimet e reklamimit (televizionit dhe radio prezantime, mirëmbajtjes ueb faqeve, njoftimet në gazeta, materiale reklamuese, etj, duke përcaktuar llojin e promovimit, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve);
5. Shpenzimet e përfaqësimit që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve të projektit/programit (duke treguar qëllimin dhe numrin e pritshëm të pjesëmarrësve, etj);
6. Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
7. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj);
8. Shpenzimet për prokurimin e pajisjeve të nevojshme për zbatimin e projektit (identifikimi i paisjes, lloji dhe shuma);
9. Shpenzimet e udhëtimit për organizimin e aktivitetit (akomodimi, transporti, mëditjet) duke specifikuar numrin e pjesëmarrësve, destinacionin, qëllimin e udhëtimit, llojin e transportit, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve;

10. Kostot e paparashikuara nuk duhet të kalojnë më shumë se 5% të shumës totale të projektit të financuar.

### 3.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë, për shembull:

1. Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
2. Kostot e blerjes së pajisjeve, mobiljeve, dhe punëve të vogla ndërtimore në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
3. Shpenzimet e interesit për borxhin;
4. Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
5. Pagesa e bonuse për punonjësit;
6. Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
7. Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
8. Blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobilje etj;
9. Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
10. Donacionet bamirëse;
11. Kredi për organizata të tjera apo individ;
12. Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

### 4. Si të aplikoni

**Lista e dokumenteve të nevojshme Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:**

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Formulari i propozim buxhetit;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit (nëse është e aplikueshme);
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
7. Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Formulari për deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit (për ekspertet e angazhuar);
9. Deklaratë vjetore për vitin 2023/2024/2025, (pasqyrat financiare nga ATK );
10. Dokument/e që dëshmojnë mbi qarkullimin e përgjithshëm financiarë të OJQ-së gjatë 3 viteve të fundit para datës së publikimit të kësaj thirrje publike, të cilat duhet të jenë të barabarta me ose të tejkalojnë vlerën e përgjithshme 200,000.00 €
11. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore;

12. Dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale;
13. Dëshmi se ndaj OJQ-së nuk ka evidencë se është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit.
14. Organizatat që aplikojnë në këtë thirrje, duhet që në 5 vitet para datës së publikimit të kësaj thirrje publike të kenë së paku tre (3) referenca/dëshmi relevante për projekte të realizuara që janë relevante me qëllimin dhe objektivat e kësaj thirrje
15. Konfirmimi nga banka për llogarinë aktive të OJQ-së.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në web faqen e MAPL-së.

#### **4.1 Forma e projekt propozimit**

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike. Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Kjo formë duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe e vulosur.

#### **4.2 Forma e propozim buxhetit**

Formulari i propozim buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim. Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë. Kjo formë duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar dhe e vulosur.

#### **4.3 Dorëzimi i aplikacioneve**

Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Arkivin e MAPL në zarf të mbyllur, *(në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit)* ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike USB. Dokumentet e kompletuara dorëzohen vetëm fizikisht jo më vonë se data 21.05.2026 ora 16:00 në adresën e mëposhtme:

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, ish-Pallati i Rilindjes, Kati I (përdhese)  
Prishtinë, Kosovë, 10000  
Kontakt: tel: +383(038) 200 64 209  
E-mail: [info.mapl@rks-gov.net](mailto:info.mapl@rks-gov.net)

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

#### **4.4 Afati për dorëzimin e aplikacioneve**

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve në MAPL është deri më: 21.05.2026, në orën 16:00. Aplikantit do ti lëshohet një dëshmi se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së thirrjes. Aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

#### **4.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar pyetje në e-mail adresën: [info.mapl@rks-gov.net](mailto:info.mapl@rks-gov.net), jo më vonë se, 11.05.2026. Përgjigjet do të kthehen në formë elektronike.

## **5 Vlerësimi i aplikacioneve / Fazat**

### **5.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme**

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve. MAPL do të themeloj një komision vlerësues në përputhje me rregulloren i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet e thirrjes publike.

- Në fazën e parë do të bëhet vlerësimi nga aspekti procedural. Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjithë aplikantëve që i plotësojnë kushtet për vlerësim të përmbajtjes së projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara;
- Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikacioneve nga ana e Komisionit vlerësues. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të rregullores dhe formularit të vlerësimit (shih më poshtë);
- Faza përmbajtjesorë aplikantët e parakualifikuar mund të ftohën të prezantojnë projekt propozimet;
- Faza e nënshkrimit të kontratave;
- Faza e implementimit;
- Raporti përfundimtar.

### Forma e Vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë të ndarë në disa fusha të vlerësimit. Në çdo fushë të vlerësimit janë caktuar pikët në mes të 1 dhe 5, në përputhje me kategoritë e mëposhtme të vlerësimit:

1 = nuk është e mjaftueshme, 2 = mjaftueshëm, 3 = mirë, 4 = shumë mirë, 5 = shkëlqyeshëm.

#### A. Kapaciteti institucional i organizatës (25 pikë)

Kapaciteti dhe përvoja profesionale e organizatës dhe organizatës partnere (nëse ka) për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit	1	2	3	4	5
Kapaciteti dhe struktura e menaxhimit të projektit nga organizata dhe organizata partnere (nëse ka) si: personeli, paisjet dhe aftësia për të udhëheqë buxhetin e projektit	1	2	3	4	5
Përvoja dhe njohuritë e stafit dhe ekspertëve (CV-të) e organizatës për implementimin e projektit	1	2	3	4	5
Struktura e qartë e menaxhimit të projektit dhe ndarja e përgjegjësi, detyrimeve të anëtarëve të ekipit	1	2	3	4	5
Angazhimi i grupeve të marginalizuara (grave, personave me aftësi të kufizuar, komuniteteve) apo vullnetarëve në zbatimin apo aktivitetet e projektit.	1	2	3	4	5

#### B. Rëndësia e projektit (40 pikë)

Rëndësia e projektit për synimet, objektivat dhe fushat prioritare të thirrjes	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i objektivave të projektit të cilat janë realisht të arritshme	1	2	3	4	5
Aktivitetet janë të qarta, efektive, arsyeshme, kuptueshme dhe të zbatueshme	1	2	3	4	5
Përcaktimi i qartë i rezultateve dhe ndërlidhja e aktiviteteve me rezultatet e përcaktuara	1	2	3	4	5
Identifikimi i qartë i përfituesve të projektit dhe aktivitete që targetojnë përfituesit në mënyrë efektive	1	2	3	4	5
Identifikimi dhe angazhimi i akterëve relevant në implementimin e projektit dhe arritjen e rezultateve	1	2	3	4	5
Projekti ka definuar mirë nevojat dhe mënyrën se si nevojat do të adresohen përmes aktiviteteve	1	2	3	4	5
Janë paraparë rreziqet e mundshme dhe hapat për mënjanimin e rreziqeve	1	2	3	4	5

#### C. Buxheti dhe shpenzimet (20 pikë)

Kostot e projektit janë në përputhje me rezultatet që projekti parasheh të arrij	1	2	3	4	5
Kostot e projektit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara	1	2	3	4	5
Kostot e projektit janë të arsyeshme dhe të bazuara në çmimet e tregut	1	2	3	4	5

Kostot e projektit janë reale me kohëzgjatjen e pritshme të projektit	1	2	3	4	5
<b>D. Ndikimi i projektit (15 pikë)</b>					
Projekti është inovativ dhe kreativ në arritjen e objektivave	1	2	3	4	5
Projekti ndikon në përmasimin e gjendjes së përgjithshme në fushën në të cilën aplikohet	1	2	3	4	5
Rezultatet e projektit janë të qëndrueshme	1	2	3	4	5
<b>TOTAL</b>	<b>100 pikë</b>				

## 5.2 Publikimi i vendimit paraprak

Pas përfundimit të vlerësimeve, rezultatet paraprake të vlerësimit publikohen si vendim në faqen elektronike të MAPL-së.

Rezultatet paraprake shndërrohen në rezultatet përfundimtare nëse brenda afatit të paraparë nuk paraqitet ndonjë ankesë. Nëse është paraqitur ndonjë ankesë, rezultatet paraprake shndërrohen në rezultate përfundimtare pasi të jenë trajtuar ankesat e aplikantëve.

## 5.3 Dokumentacion shtesë

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, MAPL do të kërkojë nga aplikuesi dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.
- Dëshmi se ndaj OJQ-së nuk ka evidencë se është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë. Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar e që është **jo më pak se 5 ditë pune**, aplikimi do të refuzohet. Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se aplikues nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/ programeve të përzgjedhura për financim.

## 6. Kalendari indikativ i realizimit të thirrjes

30.04.2026 - Hapja e thirrjes

21.05.2026 - Afati i fundit për aplikimet

11.05.2026 - Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen

- 11.05.2026 - Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen
- 28.05.2026 - Publikimi i rezultateve paraprake, njoftimi i aplikantëve
- 02.06.2026 - Afati për dorëzimin e ankesave
- 08.06.2026 - Vendimi i Komisionit të Ankesave
- 30.06.2026 - Nënshkrimi i kontratës
- 30.11.2026 - Dorëzimi i raportit përfundimtar pas përfundimit të projektit

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e MAPL-së.

### **Periudha dhe shtrirja gjeografike e zbatimit të projekteve**

Periudha e zbatimit të projektit është nga momenti i nënshkrimit të kontratës e deri me 30.11.2026. Projekti do të zbatohet në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

### **6. Ankesat**

Kundër vendimit të Komisionit Vlerësues aplikantët mund të ushtrojnë ankesë pranë Komisionit të Ankesave, si në vijim:

- Ankesë ndaj vendimit për diskualifikim për shkak të mos përmbushjes së kritereve formale gjatë vlerësimit të aplikacionit në aspektin procedural, dhe
- Ankesë ndaj vendimit për ofrimin apo mos ofrimin e mbështetjes financiare.

Të gjitha ankesat në lidhje me thirrjen duhet të dorëzohen në arkivin e MAPL-së në kopje fizike dhe atë nga aplikuesi apo i autorizuari i ti jo më vonë se 02.06.2026 ora 16:00. Komisioni i Ankesave, në përputhje me rregulloren do të merr vendimin deri më 07.06.2026

### **7. Lista e formave**

Lista e formularëve të nevojshëm të paraparë sipas rregullores dhe manualit për implementimin e projektit:

1. Formulari i Projekt-propozimit;
2. Formulari i Propozim buxhetit;
3. Formulari i Deklaratës së Partneritetit (nëse ka);
4. Forma e Deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë;
5. Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit apo burime të tjera;
6. Formulari për Deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të programit/projektit.



**Republika Kosovo**  
**Republika Kosovo od Kosovo**  
**Vlada - Vlada - Vlada**

*Ministarstvo lokalne samouprave*  
*Ministarstvo administracija lokalno samouprava*  
*Ministarstvo od Lokalno Vlada Administracija*

Priština, 30.04.2026.

